

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjastë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

RAPORT I VITIT 2025 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN

1. Përmbledhja Ekzekutive

(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (në vijim MAPA) ka zhvilluar procesin e konsultimit publik për projektaktet e mëposhtme:

- ❖ Projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- ❖ Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”;
- ❖ Projektvendimi ‘Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve”.

Në të gjitha rastet, procesi i konsultimit publik është realizuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe me parimet e transparencës, përfshirjes dhe aksesueshmërisë. Projektligjet e sipërcituara janë publikuar në *Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik (RENJK)* për një periudhë (*minimale*) 20-ditore pune. Ndërkaq, aktet janë mbështetur nga mekanizma shtesë komunikimi, përfshirë komunikimet elektronike zyrtare nëpërmjet e-mailit dhe organizimit të takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesuara dhe grupet e interesit, me qëllim garantimin e një dialogu gjithëpërfshirës dhe të hapur. ~~cilësor.~~

Konkretisht, në total, gjatë konsultimeve për dy projektligjet, përkatësisht, projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” janë marrë në total 171 komente dhe rekomandime nga palët e interesuara (75 për projektligjin e sinjalizuesve dhe 96 për projektligjin e lobimit), duke reflektuar një nivel të lartë interesi dhe angazhimi nga shoqëria civile, ekspertët dhe aktorët e tjerë joqeveritarë. Nga këto, 67 komente janë pranuar plotësisht dhe 25 janë pranuar pjesërisht, çka tregon se mbi gjysmën e kontributeve kanë pasur ndikim real në përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së projektakteve. Ky fakt dëshmon se procesi i konsultimit nuk ka qenë thjesht formal, por ka shërbyer si një instrument efektiv për rritjen e cilësisë së politikëbërjes dhe legjislacionit.

Mësimi kryesor i nxjerrë nga ky proces është se përdorimi i metodave të kombinuara të konsultimit (RENJK, takime/tryeza dhe email) rrit ndjeshëm nivelin e pjesëmarrjes, cilësinë e komenteve dhe transparencën e procesit të hartimit të projektligjeve. Angazhimi i aktorëve të ndryshëm ka ndihmuar në identifikimin e çështjeve praktike, paqartësive dhe nevojave për përmirësim të dispozitave ligjore, duke kontribuar në një kuadër rregullator më të qartë, më të zbatueshëm dhe më të pranueshëm nga publiku.

Sfidë kryesore mbetet nevoja për të zgjeruar më tej bazën e aktorëve që marrin pjesë në konsultime, veçanërisht përfshirjen e aktorëve të *sektorit privat* dhe të *publikut më të gjerë*, si dhe forcimin e kapaciteteve për analizimin dhe sistematizimin e një numri të madh komentesh. Në të njëjtën kohë, përvoja e këtij gjashtëmujori tregon se ekzistojnë mundësi të qarta për të thelluar më tej dialogun me palët e interesuara dhe për të rritur ndikimin e konsultimeve publike në hartimin e politikave dhe akteve normative.

Ndërkaq, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka realizuar procesin e konsultimit publik për një projektakt, konkretisht projektvendimi “*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve*”.

Qëllimi i këtij projektvendimi është bashkërendimi, koordinimi dhe harmonizimi i përpjekjeve e nismave të të gjitha institucioneve në vend, duke krijuar kuadrin e nevojshëm për bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve, përmes roleve e përgjegjësi të tyre institucionale si dhe synon të përcaktojë orientimet politike që duhen ndërmarrë nga institucionet për reformimin e administratës publike, duke bashkëvepruar me komunitetin, ekspertë të fushës dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe adresimin e sfidave tek institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor.

Strategjia *Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025-2030 (SNRAP)* shërben si korniza strategjike që do të udhëheqë zbatimin e reformave të Qeverisë Shqiptare dhe të gjithë institucioneve të tjera të përfshira për RAP deri në fund të vitit 2030. Kjo reformë është prioritet kombëtar, në përputhje me qasjen e Komisionit Evropian ndaj politikës së zgjerimit. Me metodologjinë e re të zgjerimit, Reforma në Administratën Publike, pjesë e Grupkapitujve “*Themeloret*”, përbën një kusht të rëndësishëm në përparimin e procesit të negociatave, si shtyllë thelbësore për mirëfunksionimin e shtetit dhe si parakusht për avancimin e agjendës evropiane.

Sa më lart, duke mbajtur në konsideratë që fusha e veprimit të projektvendimit ishte e gjerë dhe si rezultat palët e interesuara mund të ishin të shumta, publikimi i projektaktit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u vlerësua si metoda më efektive për konsultimin publik. Konsultimi elektronik u hap me publikimin e projektaktit në REKNJ më datë 03.02.2025 dhe u mbyll më 03.03.2025. Akti pati 2051 vizitorë dhe 42 komente të ardhura me email apo shkresërisht nga shoqëria civile. Në përfundim të konsultimit elektronik, megjithëse numri i vizitorëve në RENJK ishte i konsiderueshëm, rezultoi se nuk kishte komente në lidhje me projektvendimin.

MAPA do të vijojë të zbatojë një qasje të hapur, transparente dhe gjithëpërfshirëse në proceset e konsultimit publik, duke e konsoliduar konsultimin si një mjet kyç për përmirësimin e cilësisë së legjislacionit dhe forcimin e besimit të publikut në procesin e vendimmarrjes.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike:

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara (nëse i referohemi miratimit në Këshillin e Ministrave) në vitin 2025, bazuar në proceset e konsultimit publik të zhvilluara nga MAPA, është **18 (tetëmbëdhjetë)**, përkatësisht:

- numri i përgjithshëm i akteve të miratuara (të hartuara nga Departamenti i Administratës Publike) ishte **16 vendime të Këshillit të Ministrave**.
- Numri i përgjithshëm i akteve për projektligjet e fushës antikorrupsioni, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025 është **2 (dy)**

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, tre projektakteve të miratuara gjatë vitit 2025 kanë qënë objekt i konsultimit publik, konkretisht:

- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimt 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve”;
- Projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Numri i ligjeve me raporte VNR-je që janë konsultuar gjatë kësaj periudhe është **2 (dy) nën fushën e** fushës antikorrupsionit (Projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”). Për vitin 2025, DAP nuk ka patur asnjë ligj të konsultuar.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

MAPA ka patur **6 akte ne PPAP dhe PKIE**, konkretisht, **i)** Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", **ii)** Për planin vjetor të pranimt në institucionet e administratës shtetërore pjesë të shërbimit civil, për vitin 2025, **iii)** Për hapjen e procedurës së pranimt në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025, **iv)** Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, **v)** Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, **vi)** Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve".

Numri i projektakteve të parashikuara në PPAP, PKIE apo dokumentet strategjike, për vitin 2025, të cilat u konsultuan gjatë vitit 2025 ishte 4(katër), e ndërsa nga këto, ato që u **miratuan brenda këtij viti në Këshillin e Ministrave**, ishte **3 (tre)** të tilla (projektvendime).

Gjatë periudhës së raportimit, janë konsultuar publikisht (në masën 100%) të gjitha aktet e parashikuara për miratim në PPAP, PKIE dhe dokumentat politiko-strategjike në fuqi, për të cilat, në përputhje me natyrën e objektin e nismës, parashikohet detyrimi ligjor për kryerjen e procesit të konsultimit publik. **nuk** ka pasur raste kur janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike për aktet e përfshira në: a) Programin

Analitik; b) PKIE; c) Dokumente strategjike, përveç VKM nr. 22, datë 9.1.2025 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të këshillit të ministrave, “për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individ tjetër jashtë shërbimit civil”, të ndryshuar, e cila nuk është konsultuar, duke qenë se nuk ishte projektligj apo projektvendim që miraton dokumente strategjike dhe politika me interes të lartë publik, për të cilat, lind detyrimi për konsultim publik bazuar në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2025, të gjitha konsultimet publike të zhvilluara nga MAPA, janë kryer për **3 projektligje**, konkretisht:

- VKM nr. 472, datë 31.7.2025 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve”;
- Projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të funksionimit të mekanizmit të konsultimit publik, konstatohet se bazat e vendosura për këtë proces janë të qëndrueshme dhe konsolidohen gradualisht nga viti në vit, gjë që verifikohet edhe nga praktika e ndjekur gjatë vitit 2025. Proceset e konsultimit përgjatë këtij viti kanë respektuar standardet ligjore dhe afatet minimale të parashikuara (20 ditë pune), duke u mbështetur në përdorimin e formateve të kombinuara të konsultimit, përfshirë RENJK, takime dhe tryeza konsultative, si dhe komunikimin elektronik. Analiza e këtyre praktikave tregon se kjo qasje ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes, të numrit dhe diversitetit të aktorëve të angazhuar, si dhe në përmirësimin e cilësisë së komenteve të paraqitura, të reflektuara edhe në numrin e komenteve të pranuar dhe të integruara në aktet përfundimtare, si rezultat i dialogut më të strukturuar dhe i ndërveprimit më të drejtpërdrejtë me palët e interesuara. Njëkohësisht, mbetet i nevojshëm vijimi i përpjekjeve për forcimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi, veçanërisht në drejtim të zgjerimit të bazës së pjesëmarrjes dhe rritjes së përfshirjes së aktorëve të rinj, duke garantuar që proceset e konsultimit të jenë gjithnjë e më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

I. Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve”, janë përdorur pesë metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet prej datës 3 shkurt 2025 deri në 3 mars 2025, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projektaktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 92, datë 1.8.2023 të Kryeministrit, *“Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2023-2030”*. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektaktit dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projektaktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit.
4. Marrje e mendimeve të ministrive të linjës dërguar në datë 09.07.2025, përmes sistemit të e-akteve, si mënyrë komunikimi dhe koordinimi ndërmjet ministrive për të siguruar që të gjitha aspektet ligjore dhe të politikave janë përfshirë. Pas marrjes së mendimeve dhe reflektimit të tyre në tekstin e projektaktit nga grupi i punës, akti është rihedhur për bashkërendim në sistem, në datën 29.07.2025. Pasi u mor dakordësia e ministrive dhe institucioneve të tjera të përfshira, akti ka kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave.
5. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të Kryeministrit, ministrive të linjës, Kuvendit, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës; Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit; Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Avokatit të Popullit; Shkollës Shqiptare të Administratës Publike; me ekspertë në fushën e reformës në administratën publike nga aktorë jo-qeveritarë si: RESPA, OECD/SIGMA, IDM, UNDP ALBANIA, American Chamber of Commerce, Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, UN Women, IDRA, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe projektit EU for Good Governance etj.
6. Nëpërmjet adresave zyrtare të komunikimit elektronik të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) dhe Departamentit të Administratës Publike (DAP), si dhe përmes adresës postare zyrtare të institucionit.

II. Metodat e konsultimit të dy projektakteve të miratuara në fushën antikorrupsion ishin si më poshtë:

1. Përdorimi i Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet për dy periudhat përkatëse 20-ditore për secilin projektligj, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projektaktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupet përkatëse të punës në zbatim të urdhrave të Kryeministrit me objekt hartimin e projektligjeve. Këto takime përfshijnë mbledhje të hershme të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektligjeve dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara;
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projektaktin, por gjithashtu edhe për

shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;

4. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të institucioneve bashkëpërgjegjëse, grupeve të interesit, anëtarëve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, dhe organizatave të rrjetit antikorrupsion, si partnerë joqeveritarë me të cilët është konsoliduar një standard i rregullt bashkëpunimi dhe ndarjeje ekspertize për luftën kundër korrupsionit, veçanërisht në dimensionin e parandalimit të korrupsionit dhe promovimit të transparencës e integritetit;
5. Nëpërmjet adresave zyrtare të komunikimit elektronik të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA) dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, si dhe përmes adresës postare zyrtare të institucionit.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

MAPA ka aplikuar metodën e kombinuar të konsultimit publik përfshire, formën tradicionale sipas ligjit në fuqi, të Regjistrat Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik, organizmit të takimeve/eventeve me grupe interesi të dedikuara tematike, dhe tryezave teknike me përfaqësues institucionalë dhe jo-institucionalë, përfshirë këtu përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë, ekspertë, partnerë ndërkombëtarë, si dhe palë të tjera të interesuara, si dhe komunikimet elektornike.

Thënë kjo, në disa raste, ndër format e konsultimit publik që gjenerojnë numrin më të lartë të komenteve, rezulton organizimi i takimeve, e ndërsa në disa raste të tjera metoda e konsultimit që gjeneroi numrin më të madh të komenteve verehet konsultimi përmes Regjistrat Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik dhe komunikimi përmes emailit në adresat e kontaktit nga databza institucionale, të cilat mundësuan një pjesëmarrje më të gjerë të grupeve të interesit në hartimin e projektligjeve.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Nën drejtimin dhe koordinimin e përgjithshëm të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA), i gjithë procesi i hartimit dhe konsultimit të projektakteve është shoqëruar nga koordinim i vazhdueshëm ndërinstitutional ndërmjet institucioneve bashkëpërgjegjëse. Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë që në fazat e hershme të konceptimit të nismave, përfshirë përmes konsultimeve paraprake dhe takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesuara.

Në veçanti, që në krye të herës, bashkëpunimi është strukturuar me autoritetet e pavarura partnere, të ngarkuara me përgjegjësi kyçe në zbatimin e legjislacionit përkatës, konkretisht me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në kuadër të projektligjit për lobimin) dhe me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) (në kuadër të projektligjit për sinjalizuesit). Ky bashkëpunim i hershëm dhe i strukturuar ka qenë jetik në informimin e përmbajtjes së projektdispozitave, por edhe në rritjen e cilësisë së procesit, në qartësimin e dispozitave dhe në forcimin e zbatueshmërisë së akteve që në fazën e hartimit

Nën koordinimin e përgjithshëm të MAPA, institucionet kanë organizuar **konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit** të projektakteve, përmes **takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesuara**. DPAK ka zhvilluar tryeza teknike në **të dy rastet** për secilin prej projektligjeve të konsultuara, ku për ligjin për lobimin janë zhvilluar 4 takime teknike gjatë periudhës korrik-tetor. Departamenti i Administratës Publike ka organizuar disa takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të institucione publike të përfshira në procesin e hartimit të SNRAP 2025-2030 si: Kryeministria, Kuvendi, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Avokati i Popullit; Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Gjithashtu janë kryer konsultime paraprake me ekspertë në fushën e reformës në administratën publike nga aktorë jo-institucionalë, ku morën pjesë përfaqësues të: OECD/SIGMA, IDM, UNDP ALBANIA, American Chamber of Commerce, CoE (The Council of Europe), Delegacionit EU, Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, UN Women, IDRA, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, projektit EU for Good Governance, Ambasadës Zviceriane, Ambasadës Franceze në Tiranë, Ambasadës Gjermane, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, RESPA etj.

Gjatë muajve shkurt-mars 2025, krahas konsultimit elektronik, paketa strategjike është konsultuar edhe në tre aktivitete të dedikuara të konsultimit publik. Përgjatë gjithë procesit të hartimit të draftit të strategjisë (edhe përtej kohës së konsultimit publik) është zhvilluar një konsultim i vazhdueshëm dhe i strukturuar me institucionet e përfshira në proces, si dhe me aktorë institucionalë dhe jo-institucionalë. Ky bashkëpunim i vazhdueshëm ka synuar përfshirjen aktive të palëve të interesuara dhe reflektimin e kontributeve të tyre në përmbajtjen e dokumentit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Të gjitha konsultimet publike të zhvilluara nga MAPA gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025 kanë qenë të hapura për 20 ditë pune, në përputhje me kërkesat e ligjit. Periudha e konsultimit ka qenë e njëjtë për të tre projektaktet, ndaj nuk ka pasur dallim midis periudhës më të gjatë apo më të shkurtër të kohëzgjatjes së konsultimeve.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik ka qenë 20 ditë pune, standard i ruajtur për të gjithë aktet:

- Për “*Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve*”, konsultimi publik u hap më datë 03.02.2025 dhe u mbyll më datë 03.03.2025;
- Për projektligjin “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*” konsultimi publik u hap më 10 shtator 2025 dhe u mbyll më 8 tetor 2025;

- Për projektligjin “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, konsultimi publik u hap më 24 tetor 2025 dhe u mbyll më 21 nëntor 2025.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitet e kaluara, evidentohet konsolidim në rritje në drejtim të përmirësimit të metodave të konsultimit dhe të respektimit të kohëzgjatjes së procesit të konsultimit, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes. Sikurse në vitin 2024, MAPA ka respektuar afatet ligjore të konsultimit publik, ka garantuar transparencë dhe përfshirje të grupeve të interesit, si dhe ka plotësuar procesin përmes organizimit të takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesuara, duke forcuar dialogun dhe cilësinë e procesit konsultativ.

Njëkohësisht, me qëllim rritjen e cilësisë së legjislacionit dhe sigurimin e një reflektimi sa më të plotë të kontributeve të palëve të interesuara, është ndjekur një qasje proaktive dhe e balancuar në administrimin e komenteve të paraqitura. Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë edhe kontribute të depozituara përtej afateve formale të konsultimit publik, pa incentivuar në asnjë rast cenim të standardeve ligjore dhe procedurale që rregullojnë procesin e konsultimit publik.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Projektvendimi për “Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve” është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe Kabineti i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në bashkëpunim me Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP), përfaqësues të institucioneve si: Kryeministria, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Avokati i Popullit, Agjencia e Prokurimit Publik etj.

Gjatë procesit të hartimit të aktit, grupi i punës është mbështetur nga aktorë joqeveritarë si: ekspertë të projektit EU4GG, OECD/SIGMA, si dhe nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (RESPA), të cilët kanë kontribuar me ekspertizë teknike dhe këshillimore në përgatitjen e dokumentit. Në tre aktivitetet e dedikuara të konsultimit publik morën pjesë **mbi 100 përfaqësues** nga institucione shtetërore, shoqërisë civile, akademisë, partnerët ndërkombëtarë dhe bizneset, me qëllim adresimin e komenteve dhe sugjerimeve përkatëse nga të gjithë partnerët. Rezultat i këtyre takimeve ishte dhënia e komenteve për përmirësimin e masave të përfshira në draft-paketën e SNRAP.

Në procesin e konsultimit publik të dy projektakteve të fushës së AK janë përfshirë **28 aktorë të jashtëm**, konkretisht, **19 subjekte jo-qeveritare**, **2 partnerë/ekspertizë e huaj** dhe **7 anëtarë të grupeve ndërinstitucionale** të punës të ngritura për hartimin e këtyre projektakteve.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Struktura e anëtarëve të jashtëm përbëhej nga ekspertë individualë, projekte ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare konkretisht: mbështetje teknike e projektit EU4GG, OECD/SIGMA, si dhe nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (RESPA).

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime te hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë konsultimeve të hapura të zhvilluara në kuadër të hartimit të projektvendimit të SNRAP morën pjesë rreth **33 aktorë të jashtëm (jo-institucionalë)** ku përfshihen përfaqësues të: shoqërisë civile, akademikë, partnerëve ndërkombëtarë, ekspertë etj. Sa më sipër, 7 aktorë të konsultuar kanë përcjellë komente shkresërisht ose me email. Ndërsa, numri i palëve të interesuara që dhanë komente në konsultime ishte **5 për projektligjin e sinjalizuesve dhe 14 për projektligjin e lobimit**.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Sa i takon Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, ndër aktorët e jashtëm që kanë përcjellë komente nëpërmjet postës elektronike apo shkresërisht janë: IDM, UNDP Albania, American Chamber of Commerce, Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, UN Women, IDRA Research & Consulting, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

Për dy projektligjet në luftën kundër korrupsionit, struktura e kontribuesve përbëhej nga 2 persona fizikë dhe 17 persona juridikë (organizata jofitimprurëse), përkatësisht:

- Për projektligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, aktorët që kanë paraqitur komente janë IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim), OSCE, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Për projektligjin “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, aktorët që kanë paraqitur komente janë Qendra e Shkencës dhe Inovacionit për Zhvillim (SCiDEV), Shoqata e Bankave, IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Lëvizja Europiane në Shqipëri, Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS, Qendra A.L.T.R.I., Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, OSCE, Qendra AL-TAX dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si dhe 2 persona fizikë.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me aktet e konsultuara në vitet paraardhëse, konstatohet një trend pozitiv në drejtim të rritjes së numrit dhe diversitetit të palëve të interesuara të përfshira në procesin e konsultimit, veçanërisht sa i përket pjesëmarrjes së aktorëve jo-qeveritarë.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

-Gjatë procesit të konsultimit të projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030” janë përcjellë: **42 komente të ardhura me email apo shkrim nga aktorë jo-institucionalë.**

-Projektligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”: **75 komente**

-Projektligji “Për Lobimin”: **96 komente**

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

❖ Projektvendimi për “**Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025-2030, Planit të Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve**” (42 komente)

- ✓ 17 komente janë pranuar plotësisht;
- ✓ 3 komente janë pranuar pjesërisht;
- ✓ 22 komente janë refuzuar.

❖ Për projektligjin “**Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve**” (75 komente):

- ✓ 20 pranuar
- ✓ 5 pranuar pjesërisht
- ✓ 50 refuzuar

❖ Për projektligjin “**Për Lobimin**” (96 komente):

- ✓ 47 pranuar
- ✓ 20 pranuar pjesërisht
- ✓ 29 refuzuar

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Në lidhje me rekomandimet dhe komentet e marra gjatë procesit të konsultimit, evidentohet një trend pozitiv, si për sa i përket rritjes së numrit të rekomandimeve të paraqitura, ashtu edhe në drejtim të numrit të rekomandimeve të pranuar dhe të reflektuara në tekstin përfundimtar të aktit. Janë përdorur metoda të kombinuara (RENJK, takime/tryeza dhe email), duke rritur pjesëmarrjen dhe transparencën.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raporti VNR i projektligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” është përditësuar një herë pas përfundimit të procesit të konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Numri i raporteve të konsultimit publik të publikuara nga MAPA gjatë periudhës së raportuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike është **3 (tre)**.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka patur raporte të konsultimit publik të papublikuara gjatë vitit 2025.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

(Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Sa u përket **tre akteve**, bëjmë me dije se **MAPA** ka respektuar me rigorozytet procedurat dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- Akti /Projektligjet janë publikuar në RENJK;
- Është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- Janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre;
- Në draftin e ri të projektligjit pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimeve të palëve të interesuara.

Për këtë arsye, në lidhje me Indeksën e performancës institucionale **MAPA** është vetëvlerësuar me pikët maksimale **8** (tetë) për tre aktet/ projektligjet për të cilët procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen

(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Procesi i konsultimit publik i ndjekur nga MAPA, ka rezultuar të jetë i suksesshëm dhe gjithëpërfshirës, duke mundësuar angazhimin aktiv të qytetarëve, ekspertëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Gjatë konsultimeve janë marrë një numër i kënaqshëm komentesh dhe propozimesh, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e draft-projektligjeve. Përmes përdorimit të regjistrit elektronik dhe takimeve të drejtpërdrejta, është siguruar një dialog konstruktiv dhe gjithëpërfshirës me palët e interesuara.

Procesi ka treguar edhe rëndësinë e bashkëpunimit brenda dhe ndërinstitutional, duke garantuar që sugjerimet dhe komentet e marra të reflektohen në draftin e ri të aktit, duke e bërë hartimin e akteve normative më të mirë dhe më të qartë për publikun. Ky rezultat tregon se konsultimi publik është një mjet gjithnjë e më në rritje efektiv për përfshirje, transparencë dhe përmirësim të politikave publike. Ky standard i vendosur do të konsolidohet dhe do të ushqejë përfundimin e mekanizmit të konsultimit publik efektiv më tej për projektaktet e parashikuara për miratim në vitin 2026.

Analiza e proceseve të konsultimit publik për aktet e miratuara gjatë vitit 2025 tregon se një nga sfidat kryesore lidhet me pjesëmarrjen e kufizuar dhe mungesën e diversitetit të aktorëve të angazhuar aktivisht në këto procese. Kontributet dhe komentet kanë ardhur kryesisht nga një rreth relativisht i ngushtë aktorësh,

të përbërë nga profile të konsoliduara think tanks, partnerë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të komunitetit akademik, duke reflektuar një shkallë të ulët zgjerimi të bazës së pjesëmarrjes në konsultime.

Kjo situatë vihet re veçanërisht në fushën e reformës në administratën publike, për shkak të specifikës së lëndës dhe natyrës teknike që karakterizon diskutimet, çka ndikon në një përfshirje më të kufizuar të aktorëve të rinj, praktikuesve të sektorit publik dhe grupeve të tjera të interesit. Në praktikë, kjo reflektohet edhe në faktin se kontributet dhe komentet paraqiten përgjithësisht nga të njëjtët subjekte në shumicën e proceseve të konsultimit publik. Në të ardhmen, kjo sfidë do të adresohet përmes diversifikimit të formateve dhe kanaleve të konsultimit, duke aplikuar qasje më të targetuara, të strukturuar dhe të përshtatura sipas profileve të aktorëve, me synim zgjerimin e pjesëmarrjes së administratës vendore, praktikuesve të sektorit publik, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit